

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6701  
E premte, 9 shtator 2022  
çmimi 0.40 €

## Policia nis patrullimin në kufi me Serbinë dhe në Liqenin e Ujmanit



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

SINDIKATA PËR ARSIM KA PARALAJMËRUAR SE DO TË KETË GREVË DERI NË REALIZIMIN E KËRKESAVE TË MËSIMDHËNËSVE

## AS SBASHK-u AS QEVERIA NUK LËSHOJNË PE, GREVA VAZHDON



As Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës (SBASHK) dhe as qeveria nuk janë duke lëshuar pe sa i përket grevës në arsim. Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, ka thënë të enjten se greva në arsim do të

vazhdojë, pasi deri më tani nuk ka marrë asnjë ftesë nga kryeministri Kurti për dialog. Ndërsa Kurti dhe ministrja e Arsimit, Arbërie Nagavci, u kanë bërë thirrje mësimitdhënësve ta fillojnë mësimin

### AKTUALE



SHBA-ja, PAKO TË RE TË NDIHMËS USHTARAKE PËR UKRAINËN DHE RAJONIN

RRETH 1 000 PJESËTARË TË FSK-së DHE TË MINISTRISË SË MBROJTJES DHURUAN GJAK

PËR TETË MUAJ JANË KRYER RRETH 2 MILIONË ANALIZA, PËR MBI 338 MIJË PACIENTË

DEPUTETJA DOARSA KICA-XHELILI KALON NË LDK

### EKONOMI



GËRXHALIU: ZHVILLIMI EKONOMIK EDHE MË TUTJE NËN HIJEN E AGJENDËS POLITIKE

SINDIKATA E SEKTORIT PRIVAT KËRKON HEQJEN E KUSHTËZIMIT PËR MARRJEN E 50 EUROVE

### SPORT



EJUPI: RAHOVECI KA SYNIME TË MËDHA NË KAMPIONATIN E RI



## MBROJTJA KRITIKON ZPS-në PËR VONESËN NË NXJERRJEN E MATERIALEVE

Në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë është mbajtur të enjten konferenca e radhës mbi ecurinë e çështjes në rastin ndaj Thaçit dhe të tjerëve, ku mbrojtja ka adresuar kritika në drejtim të Zyrës së Prokurorit të Specializuar lidhur me vonesën në nxjerrjen e materialeve



## NATO-ja KONFIRMON SE IRANI QËNDRON PRAPA SULMIT KIBERNETIK NË SHQIPËRI

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Bjellorusia mban stërvitje ushtarake pranë kufirit me BE-në

MINSK, 8 SHTATOR - Zyrtarët e mbrojtjes së Bjellorusisë kanë njoftuar për nisjen e stërvitjeve ushtarake pranë kufirit me Poloninë, shtet anëtar i Bashkimit Evropian.

Ministria e Mbrojtjes tha më 8 shtator se trupat do të trajnohen "për ta çliruar territorin e okuptuar përkohësisht nga armiku" dhe për ta rimarrë kontrollin e territorit në zonat kufitare.

Kjo ministri tha se manovrat do të mbahen në bazën stërvitore

ushtarake në Brest, afër kufirit me Poloninë, por edhe në zonat përreth kryeqytetit Minsk dhe në Vitebsk në verilindje të Bjellorusisë.

Autoritetet nuk bënë me dije se sa ushtarë janë të përfshirë në këto stërvitje, por thanë se "numri i trupave pjesëmarrëse në stërvitje, numri i armëve dhe pajisjeve ushtarake, nuk tejkalon nivelin e përcaktuar sipas dokumentit të Vjenës të vitit 2011".

Lideri i kontestuar bjellorus

Aleksandr Lukashenka ka lejuar ushtrinë ruse që ta përdorë territorin e Bjellorusisë për të nisur sulme ndaj Ukrainës në fillim të pushtimit të përvokuar.

Lukashenka ka mohuar se trupat bjelloruse po marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë në asnjë armiqësi. Ka pasur raportime se disa bjelloruse kanë refuzuar që të marrin pjesë në aktivitetet në mbështetje të pushtimit rus.



## Ish-kryeministri i Pakistanit "pendohet" për deklaratat



Ish-kryeministri pakistanez Imran Khan ka pranuar se i vjen keq për komentet përcmuese për policinë dhe gjyqtarët.

Hetimet ndaj Khanit kanë nisur pasi ai e ka akuzuar policinë dhe gjyqësorin se kanë ndaluar dhe torturuar një aleat të tij. Por, në një deklaratë të dorëzuar në Gjykatën e Lartë të Islamabadit, para paraqitjes së tij më 8 shtator, Khan nuk kërkoi falje të drejtpërdrejtë.

Kjo vjen në kohën kur Khani po mban fjalime në të gjithë vendin duke kritikuar qeverinë e

kryeministrit Shehbaz Sharif dhe duke nxitur zgjedhje të reja pavarësisht prej përmbajtjeve në rreth një të tretën e vendit.

Khan u bë kryeministër në vitin 2018, por u rrëzua nga pushteti përmes një vote mosbesimi në muajin prill, pasi opozita e ka akuzuar për keqmeanaxhim ekonomik në kohën e rritjes së inflacionit.

Akuza për terrorizëm, e ngritur më 22 gusht, pasoi një fjalim të tij në Islamabad, gjatë të cilit ai u zotua se do t'i padiste oficerët e policisë dhe një gjykatës, dhe

pretendoj se ata kishin torturuar një bashkëpunëtor të ngushtë pas arrestimit të tij.

Khan, gjithashtu, duhet të paraqitet para një gjykate anti-terrorizëm më 9 shtator, kur lirimi me kusht i skadon, në një çështje të veçantë në lidhje me të njëjtat komente për gjyqtarin.

Vërshimet në Pakistan kanë mbuluar me ujë pothuajse një të tretën e këtij shteti, teksa numri i viktimave ka arritur në 1 343. Nga vërshimet janë prekur 33 milionë njerëz nga popullsia prej 220 milionë banorësh.

## ShBA-ja, pako të re të ndihmës ushtarake për Ukrainën dhe rajonin



UASHINGTON, 8 SHTATOR - Shtetet e Bashkuara kanë njoftuar edhe për 2.6 miliardë dollarë ndihmë për Ukrainën dhe shtetet e tjera me qëllim që të rritet siguria në mbarë Evropën pas pushtimit të përvokuar rus të Ukrainës.

Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, tha më 8 shtator se Shtëpia e Bardhë do të përdorë 2 miliardë dollarë nga Programi për financimin e jashtëm ushtarak për ta rritur sigurinë e Ukrainës dhe të 18 fqinjëve të saj, përfshirë edhe disa shtete të NATO-s dhe të partnerëve rajonalë të sigurisë, "që janë më

së shumti në rrezik nga agresioni rus në të ardhmen".

Njoftimi erdhi disa orë pasi sekretari amerikan i Mbrojtjes, Lloyd Austin, tha se administrata e presidentit Joe Biden ka miratuar edhe dërgimin e armëve në vlerë prej 675 milionë dollarësh. Ai tha se Uashingtoni dëshiron që Ukraina të ketë sukses në fushëbetetë kundër forcave ruse të cilat e nisën pushtimin në fund të shkurtit. "Kjo është tërheqja e 20 e armatimeve nga stoqet amerikane që i janë dhënë Ukrainës që nga gushti i kaluar",

tha Austin gjatë një takimi në bazën Ramstein në Gjermani. Ai shtoi se pakaja e ndihmës do të përfshijë obusë 105 milimetrash, raketa precize GMLRS dhe municion të artilerisë.

Përfshirë edhe pakon e fundit të 8 shtatorit, ndihma totale që administrata Biden ka dhënë për Ukrainën ka arritur në vlerën e 15.2 miliardë dollarëve.

Luftimet janë shtuar javët e fundit, teksa Ukraina ka nisur një kundërofensivë për ta rimarrë kontrollin e disa zonave që u morën nga trupat ruse në fillim të luftës.

## Edhe një delegacion i Kongresit Amerikan viziton Tajvanin

UASHINGTON, 8 SHTATOR - Edhe një delegacion i Kongresit Amerikan po viziton Tajvanin, teksa tensionet me Kinën vazhdojnë të jenë të larta rreth pretendimeve mbi këtë ishull vetëqeverisës.

Tensionet janë të larta qëkur kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve, Nancy Pelosi,

vizitoi Tajvanin më herët gjatë gushtit. Kina u kundërpërgjigj duke mbajtur stërvitje ushtarake pranë ishullit.

I udhëhequr nga demokratja Stephanie Murphy, delegacioni amerikan më 8 shtator u takua me presidenten tajvaneze Tsai Ing-wen.

Duke iu referuar kërcënimeve

ushtarake të Kinës, Tsai tha se vizita e delegacionit amerikan "tregon mbështetjen e palëkundur për Tajvanin nga Kongresi Amerikan". "Tajvani nuk do të përkulet para presionit", tha Tsai. "Ne do t'i mbrojmë institucionet tona demokratike. Tajvani nuk do të nënshtrohet", shtoi ajo.





## Rreth 1 000 pjesëtarë të FSK-së dhe të Ministrisë së Mbrojtjes dhuruan gjak

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës ka përfunduar të enjten aksioni tradicional humanitar i dhurimit vullnetar të gjakut për të dytën herë gjatë këtij viti. Me qëllim të dhënies së ndihmës për Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut dhe të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, ftesës për dhënie vullnetare të gjakut i janë përgjigjur zëvendësministri i Mbrojtjes, Shemsi Syla, si dhe këshilltari amerikan i ministrit Mehaj, Thomas Niblock, dhe rreth një mijë ushtarakë të FSK-së nga të gjitha kazernat dhe zyrtarë të

Ministrisë së Mbrojtjes.

Aksioni për dhurimin vullnetar të gjakut është organizuar duke u bazuar në planin operacional 2022 në koordinim me Qendrën e Mjekësisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Qendrës Kombëtare të Kosovës për Transfuzion të Gjakut (QKKTGJ).

Përveç aksioneve të rregullta vjetore për dhurimin vullnetar të gjakut, zyrtarët dhe ushtarakët e MM-së dhe FSK-së vazhdimisht u përgjigjen kërkesave për dhënie të gjakut si nga qytetarët, po ashtu edhe nga institucionet tona shëndetësore.



## Policia nis patrullimin në kufi me Serbinë dhe në Liqenin e Ujmanit

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Policia e Kosovës ka nisur patrullimin uhor në vijën kufitare me Serbinë në të gjithë hapësirën e Liqenit të Ujmanit, ka bërë me dije ministri i Brendshëm,

Xhelal Sveçla. “Për herë të parë që nga paslufta, pas krijimit të njësitit për patrullim uhor, Policia e Kosovës sot filloi patrullimin e rregullt të vijës kufitare në mes të

Republikës së Kosovës dhe Serbisë si dhe gjithë hapësirës së Liqenit të Ujmanit. Tashmë kontrolli i kufirit shtetëror është më i plotë”, ka shkruar Sveçla në “Facebook”.

## Eugen Cakolli thotë se “Guxo” duhet të ketë një kryetar, jo dy

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Ministri i Bujqësisë, Faton Peci dhe ministrja e Punëve të Jashtme, Donika Gërvalla, janë zgjedhur kryetarë të përbashkët të partisë “Guxo”.

Hulumtuesi në Institutin Demokratik të Kosovës (KDI) po e konsideron se partia “Guxo” ka bërë shkelje gjatë Kuvendit Zgjedhor të mbajtur një ditë më parë.

Cakolli ka theksuar se Ligji për Zgjedhje dhe Rregulla Zgjedhore 01/2013 tregon shprehimisht se partitë politike duhet të kenë “kryetar” dhe jo “kryetarë”. Ai ka thënë se

statutet e partive duhet t'i përcaktojnë procedurat për zgjedhjen e një kryetari. “Guxo e paska filluar zyrtarisht aktivitetin partiak/politik me shkelje të legjislacionit gjatë zgjedhjes së strukturave udhëheqëse të saj. Sado që mund të duket zgjidhje kreative, legjislacioni zgjedhor në Kosovë nuk e njeh mundësinë e ‘bashkë-kryesimit’ të partive. Ligji për Zgjedhje dhe Rregulla Zgjedhore 01/2013 përcaktojnë qartazi që partitë politike kanë ‘kryetar’ e jo ‘kryetarë’. Rrjedhimisht, statutet e partive duhet t'i përcaktojnë

procedurat për zgjedhjen e vetëm një kryetari. Ndryshe, nuk do të mund të zbatohen obligimet për funksionim të rregullt që ka partia politike, respektivisht kryetari/ja e saj - si instancë kryesore për, minimalisht, nënshkrimin e dokumenteve zyrtare dhe përgjegjësisë ligjore. Prandaj, Zyra do të duhej t'i propozonte KQZ-së mosnjohjen e këtij Kuvendi dhe vendimmarrjes së partisë ‘Guxo’ lidhur me këtë çështje, si dhe ta obligojë atë që ta harmonizojë statutin e partisë me kornizën ligjore”, ka shkruar Cakolli në “Facebook”.



## NATO-ja konfirmon se Irani qëndron prapa sulmit kibernetik në Shqipëri

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Aleanca ushtarake e NATO-s ka konfirmuar se prapa sulmit kibernetik ndaj Shqipërisë, qëndron Republika Islamike e Iranit.

Më 8 shtator, përmes një deklarate, NATO dënoi fuqishëm sulmin kibernetik të korrikut, duke thënë se sulme të tilla kanë për synim të krijojnë destabilitet dhe ta dëmtojnë sigurinë e aleatëve të NATO-s. “NATO dhe aleatët mbështesin Shqipërinë në forcimin e aftësive mbrojtëse kibernetike që t'i bëjë ballë dhe të

kundërpërgjigjet ndaj veprimeve të tilla dashakeqe në të ardhmen”, u tha në njoftimin e NATO-s.

Edhe sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka dënuar sulmin kibernetik të Iranit ndaj Shqipërisë.

Në “Twitter”, Stoltenbergu ka thënë se NATO-ja është e përkushtuar të vazhdojë ta rrisë sigurinë për të penguar dhe mbrojtur kundër kërcënimeve kibernetike. “Dënoj fuqishëm sulmin e fundit kibernetik ndaj Shqipërisë, të cilin Tirana dhe aleatët e tjerë ia atribuojnë



Iranit. NATO dhe ekspertët e aleatëve po ofrojnë mbështetje. NATO-ja është e përkushtuar të

vazhdojë ta rrisë sigurinë për të penguar dhe mbrojtur kundër kërcënimeve kibernetike”, ka

shkruar Stoltenbergu.

Sipas kryeministrit Edi Rama, katër grupe iraniane janë organizuar për sulmin kibernetik në Shqipëri, “ndër to edhe një ndër grupet më famëkeqe të terrorizmit kibernetik ndërkombëtar”.

Rama ka thënë se objektivi i këtij sulmi ishte shkatërrimi i infrastrukturës digjitale të Qeverisë së Shqipërisë, paralizimi i shërbimeve publike, si dhe grabitja e të dhënave dhe të komunikimeve elektronike nga sistemet qeveritare.





SINDIKATA PËR ARSIM KA PARALAJMËRUAR SE DO TË KETË GREVË DERI NË REALIZIMIN E KËRKESAVE TË MËSIMDHËNËSVE

## As SBASHK-u as qeveria nuk lëshojnë pe, greva vazhdon

As Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës (SBASHK) dhe as qeveria nuk janë duke lëshuar pe sa i përket grevës në arsim. Kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, ka thënë të enjten se greva në arsim do të vazhdojë, pasi deri më tani nuk ka marrë asnjë ftesë nga kryeministri Kurti për dialog. Ndërsa Kurti dhe ministrja e Arsimit, Arbërie Nagavci, u kanë bërë thirrje mesimdhënësve ta fillojnë mësimin

**EPOKA ERE** Mal QORRAJ

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Qindra mijëra nxënës në Kosovë mbeten jashtë shkollave në ditën kur do të duhej të niste java e dytë e mësimëve. Sindikalistët e arsimit këmbëngulin se do ta vazhdojnë grevën derisa të plotësohet kërkesa e tyre për mbështetje financiare prej 100 eurosh në muaj për të gjithë punonjësit e arsimit.

Qeveria e Kosovës në përgjigje thotë se Projektligji për Pagat, që parasheh rritje, do të dalë në miratim së shpejti dhe kërkon hapjen e shkollave.

Këshilli i Prindërve i Kosovës, në anën tjetër, u bënë thirrje të dyja palëve t'i gjejnë zgjidhje grevës, duke thënë se bllokimi i sistemit arsimor është i papranueshëm.

Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës

dhe Kulturës (SBASHK), Rahman Jasharaj, ka thënë se greva në arsim do të vazhdojë. Sipas tij, qeveria Kurti s'ka treguar as dëshirë e as vullnet që të bisedojë me grevistët. "Greva po vazhdon, fatkeqësisht, për shkak të mungesës së vullnetit të qeverisë që të ulët me përfaqësuesit e sindikatës për të gjetur një zgjidhje. Jemi në komunikim të vazhdueshëm edhe me unionin e sindikatave të Evropës dhe kemi marrë letër mbështetjeje në emër të 10 milionë anëtarëve", është shprehur Jasharaj në një konferencë për medie, ku të pranishëm ishin edhe kryetari i Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë (SPASH), Nevrus Kaptelli, si dhe nënkryetari i Sindikatës së Arsimit të Maqedonisë Veriore (SONK), Tafa Ameti.

Ai ka theksuar se nëse kryeministri Kurti ka vullnet të

bisedojë me ta, çështja e grevës kryhet brenda një dite. "Ne nuk po shkelim të drejta të askujt, por nuk është mirë të tentohet në opinion se po shkelen të drejtat e dikujt. Grevën e kemi përdorur pas nëntë muajve, qeveria s'e ka bërë asnjë

angazhim, por vetëm fyerje. Ne jemi të gatshëm të bisedojmë me qeverinë nëse na thërret. Po pati dëshirë dhe vullnet, çështja do të kryhej brenda një dite", ka thënë Jasharaj, duke shtuar se po komunikojnë edhe me Sindikatën e Pavarur të Arsimit të Shqipërisë. "SBASHK-u dhe sindikatat e tjera janë të hapura për të dialoguar me qeverinë. Deklarata e ministres së Arsimit, se dyert janë të hapura, por SBASHK-u nuk do dialog, janë porosi të gabuara. Në të kaluarën jemi takuar me të, por

tani nuk po ka kohë sepse po shkon në vizita", ka thënë Jasharaj.

Ndërkaq kryeministri Albin Kurti ka thënë të enjten se zgjidhja e vetme për daljen nga situata në arsim, ku shumica e shkollave janë në grevë, është kthimi në shkolla i nxënësve dhe mesimdhënësve. "Nga kjo situatë duhet të dilet duke nisur mësimi për nxënësit, duke shkuar mesimdhënësit dhe nxënësit në shkolla. Nuk zhvillohet vendi pa arsimim", ka deklaruar ai.

### Nagavci: I ftoj të gjithë mesimdhënësit të kthehen në shkolla

Ministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit, Arbërie Nagavci, ka njoftuar të enjten se ka vizituar disa shkolla në të cilat ka filluar të mbahet procesi mësimor. "Me kryeministrin ishim në Qendrën e Kompetencës 'Shtjefën Gjeçovi' në Prishtinë. Këtu procesi mësimor është duke u zhvilluar normalisht. Po ashtu, kam vizituar shkollën 'Faik Konica' në kryeqytet, ku disa

mësimdhënës janë duke mbajtur mësim. Mësimi po mbahet në disa klasa e shkolla të ndryshme në Prishtinë, Podujevë, Mitrovicë, Vushtrri, Pejë, Deçan, Gjilan, Kamenicë, Gjakovë, Ferizaj, Shtime etj", ka shkruar Nagavci në "Facebook". Ajo ka thënë se, ndonëse shumica e mesimdhënësve janë në grevë, ka mesimdhënës të cilët janë bashkë me nxënësit duke mbajtur mësim. "Ashtu siç

kemi edhe prindër të cilët po i dërgojnë fëmijët në shkollë ndonëse mesimdhënësit nuk po mbajnë mësim. Si ministre e Arsimit edhe një herë i ftoj të gjithë mesimdhënësit të kthehen në shkolla pranë nxënësve të tyre e ta fillojnë mësimin. Që nga fillimi i mandatit jemi duke u angazhuar shumë që t'i përmirësojmë kushtet e punës në shkolla", ka deklaruar Nagavci.



## Mbrojtja kritikon ZPS-në për vonesën në nxjerrjen e materialeve

Në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë është mbajtur të enjten konferenca e radhës mbi ecurinë e çështjes në rastin ndaj Thaçit dhe të tjerëve, ku mbrojtja ka adresuar kritika në drejtim të Zyrës së Prokurorit të Specializuar lidhur me vonesën në nxjerrjen e materialeve

HAGË, 8 SHTATOR - Në Gjykatën Speciale në Hagë të enjten është mbajtur seanca e radhës për ecurinë e procesit të çështjes kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit.

Sanca ka nisur me prezantimin e palëve.

Ish-presidenti Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentari Kadri Veseli, ish-kryeparlamentari Jakup

Krasniqi dhe ish-deputeti Rexhep Selimi nuk ishin të pranishëm në sallë, por e kanë përcjellë atë përmes videolidhjes.

Avokatët Gregory Kehoe (mbrojtës i Hashim Thaçit), Ben Emmerson (mbrojtës i Kadri Veselit), Venkatesh Alagendra (mbrojtësja e Jakup Krasniqit) dhe David Young (mbrojtës i Rexhep Selimit) kanë shprehur shqetësimet e tyre për vonesën

për nxjerrjen e materialeve shfaqësuese.

Avokati i ish-presidentit Hashim Thaçi, Gregory Kehoe, ka adresuar kritika në drejtim të Zyrës së Prokurorit të Specializuar lidhur me vonesën për nxjerrjen e materialeve.

Kehoe ka thënë se qëndrimi i ZPS-së sa i përket rregullës 103, që lidhet me nxjerrjen e materialeve, është shqetësues. “Unë ju

drejtohem zotëri gjykatës që ata nuk e kanë zbatuar urdhrin tuaj. Qëndrimi që ata kanë është shqetësues dhe ende nuk kemi një përgjigje pse ka vonesa për nxjerrjen e materialeve dhe me siguri ne nuk e dimë sa kemi në horizont, ka ende materiale për t’u nxjerrë 30 ditë para gjyqimit do të flasim edhe për ato gjatë ditës, bazuar në parashtrimet e djeshme të ZPS-së. Pyetja është

pse po ndodh, nuk marrim përgjigje, marrim një përgjigje disi agresive ndaj pyetjes suaj i nderuar gjykatës”, ka thënë avokati i Thaçit.

Edhe avokati i Rexhep Selimit ka pasur të njëjtin shqetësim. “Ka kaluar më shumë se një vit dhe ne nuk mund t’i mbajmë të akuzuarit përgjithmonë në paraburgim”, është shprehur avokati David Young.



## Kurti takon ministren e Mbrojtjes së Zvicrës, temë diskutimi bashkëpunimi i ndërsjellë

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pritur të enjten në takim ministren e Mbrojtjes së Zvicrës, Viola Amherd. Në njoftimin për medie të qeverisë thuhet se Kurti e ka falënderuar edhe për ndihmën e vazhdueshme në programet e zhvillimit të ekonomisë dhe demokracisë, duke shprehur mirënjohjen e thellë për kontributin e Zvicrës dhënë Kosovës para, gjatë dhe pas luftës dhe pas pavarësisë së Kosovës.

Ai ka theksuar se Kosova dhe Zvicra ndajnë vlerat e përbashkëta, me mërgatën tonë në Zvicër, që janë urë lidhëse mes dy shteteve tona. “Përtej



bashkëpunimit bilateral në ekonomi dhe rritjes së volumit tregtar, kryeministri theksoi

gatishtësinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës për ta zgjeruar bashkëpunimin edhe në

fushën e mbrojtjes. Duke theksuar që Kosova është tregim suksesi i zhvillimit demokratik, ai e njoftoi ministren Amherd me progresin ekonomik dhe demokratik të vendit tonë. Po ashtu, theksoi synimet dhe planet e Kosovës për anëtarësim në Partneritetin për Paqe të NATO-s, Këshillin e Evropës, si dhe aplikimin për anëtarësim në Bashkimin Evropian”, thuhet në njoftimin për medie.

Ministrja Amherd ka treguar se Zvicra dhe Kosova ndajnë vlera të përbashkëta. Ajo ka potencuar rëndësinë e mërgatës së madhe nga Kosova që kontribuon në

ekonominë e Zvicrës. “Duke rithesuar mbështetjen e Zvicrës për Kosovë dhe zhvillimin e saj demokratik, ajo tha se për Zvicrën është shumë e rëndësishme të ketë shtete stabile dhe sovra në rajonin e Ballkanit. U potencua gatishmëria e Zvicrës për të ndihmuar e asistuar Qeverinë e Republikës së Kosovës për rritje të mëtejme të indikatorëve pozitivë ekonomik”, është thënë në njoftim. Gjatë takimit është biseduar për gjendjen e sigurisë në Kosovë, rolin e KFOR-it, situatën politike në rajon, rëndësinë e Procesit të Berlinit si dhe për dialogun e Brukselit.

Kurti ka thënë se si asnjë qeveri më herët kanë ndërmarrë masa sociale për përmirësimin e pozitës së gjithë qytetarëve, përfshirë edhe mësimdhënësit. Kryetari i Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë (SPASH), Nevruz Kaptelli, u ka bërë thirrje kryeministrit Albin Kurti dhe ministres së Arsimit, Arbërie Nagavci, të ulen në tavolinën e bisedimeve me

sindikatat dhe të bëjnë zgjidhje për kërkesat e këtyre të fundit. “Sindikata e Pavarur e Arsimit në Shqipëri që unë përfaqësoj vlerëson ndihmën që Qeveria e Kosovës ka dhënë për qytetarët e saj gjatë pandemisë dhe krizës me fillimin e luftës në Ukrainë. Ajo që kemi përfituar ne në Shqipëri ka qenë disa herë më e vogël se ajo që ka dhënë qeveria juaj. Por, sot jam këtu për t’i

mbështetur vëllezërit tanë të SBASHK-ut në grevën që kanë nisur për t’i realizuar ato kërkesa që ne i vlerësojmë të drejta. I bëj thirrje ministres së Arsimit dhe kryeministrit që të ulen në tavolinën e bisedimeve dhe të flasin për kërkesat e SBASHK-ut, sepse nuk ka asnjë rrugë tjetër. Një qeveri e përgjegjshme duhet së pari t’i vlerësojë sindikatat e mësuesve.

Të gjithë ne jemi produkt i mendjes dhe punës së mësuesve. Nëse Qeveria do që Kosova të zhvillohet, duhet ta vlerësojë maksimalisht arsimin, pra më shumë buxhet për arsimin dhe paga më të lartë për mësimdhënësit”, ka thënë Kaptelli.

Përfaqësues të shoqërisë civile në Kosovë thonë se dialogu social midis qeverisë dhe

sindikatave është i nevojshëm që të shmangët paralizimi i institucioneve.

Gjatë dy vjetëve të parë të pandemisë së koronavirusit, më 2020/21, nxënësit në Kosovë kanë kaluar në mësim online në disa periudha kohore. Tani, kur pandemia është më e qetë dhe s’e pengon mësimin në klasa, është greva ajo që i mban nxënësit larg tyre.



## Osmani dhe shefi i Misionit të Luksemburgut bisedojnë për thellim të bashkëpunimit

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të enjten në takim shefin e Misionit të Ambasadës së Dukatës së Madhe të Luksemburgut në Kosovë, ambasadorin Eric Dietz, të cilin e ka uruar për mandatin e tij. Në njoftimin e Presidencës bëhet me dije se Osmani e ka falënderuar ambasadorin Dietz për mbështetjen e vazhdueshme të Luksemburgut ndaj Kosovës përmes projekteve

zhvillimore, sidomos në fushën e shëndetësisë, dhe ka shprehur gatishmërinë që të thellohet bashkëpunimi edhe në fushat e tjera. Presidentja Osmani ka kërkuar që mbështetja e Luksemburgut të vazhdojë edhe për integrimin euroatlantik të vendit nevojën për të vendosur përfundimisht për liberalizimin e vizave për qytetarët tanë, anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës dhe organizata të tjera ndërkombëtare.



Reagim i KMDLNj-së

## Kalimi nga partia në parti, dikush tradhtar e dikush patriot!

Deputetja e Kuvendit të Kosovës, znj. Doarsa Kica-Xhelili, që ishte pjesë e Listës LV-Guxo, kaloi në radhët e LDK-së dhe sot u zyrarizua nga kryetari i LDK-së. Nuk ishte hera e parë e sigurisht nuk do të jetë as e fundit që një deputet i Kuvendit të Kosovës ndërron parti dhe, me kalimin në partinë tjetër, në mungesë të një ligji apo rregulloreje, e bartë edhe mandatin e fituar në subjektin nga i cili largohet. E veçanta e këtij kalimi është se deputetja Kica kalon në LDK që është parti opozitare nga një Listë LV-Guxo që është në pushtet dhe që ka pushtet absolut. Kjo, pa asnjë dyshim tregon se kjo deputete është e liruar nga çdo interes personal me këtë kalim dhe se, pa asnjë dyshim më shumë do të përfitonte po të mbetej pjesë e pozitës.

KMDLNj vlerëson se ky kalim është bërë krejtësisht për çështje parimore dhe se deputetja Doarsa Kica-Xhelili po sulmohet, stigmatizohet dhe linçohet padrejtësisht dhe nga pozita hakmarrëse aq më parë që kishte raste të ngjashme në të kaluarën, jo fort të largët që një deputete, në mbledhjen e parë të konstituimit të Kuvendit kaloi nga PDK-ja në LV dhe se në sallë hyri e shoqëruar nga kryeministri Kurti duke u pritur me duartrokkitje nga deputetët e pozitës. Në mungesë të një baze ligjore që e detyron deputetin që me kalimin në një parti tjetër, ta



dorëzohet edhe mandatin e deputetit është e tepërt dhe e panevojshme të flitet për standarde morale për faktin se askush nuk po i përmbahet këtij standardi dhe se ky standard (moral) ligjërisht nuk është detyrues.

Mirëpo, KMDLNj e sheh si të panevojshme, të papranueshme dhe të

dëmshme gjuhën që po përdoret nga ish-kolegët, ish-bashkëpartiakët thuaja në të gjitha rastet kur po ka konvertime të tilla aq më parë që, po të njëjtit edhe më tutje bashkëpunojnë qoftë përmes votimit të ligjeve në Kuvend, në komisionet e përbashkëta parlamentare e sidomos gjatë udhëtimeve zyrtare jashtë

vendit, që aq fort i duan. Në fund të fundit, edhe nëse flitet për një standard moral hipotetik, nuk mundet dhe nuk është aspak e moralshme që për të njëjtin veprim dikush të cilësohet tradhtar dhe dikush tjetër patriot!

KMDLNj kërkon nga deputetët e Kuvendit të Kosovës, politikanët, pavarësisht

përkatësisë partiake dhe dallimeve tjera që të jenë të kujdesshëm në deklaratat e tyre publike në mënyrë që të mos ndikojnë në tensionimin e situatës aq më parë që deputetët e Kosovës kanë detyrim të përfaqësojnë, mbrojnë dhe promovojnë të drejtat, jo vetëm të votuesve të tyre por të gjithë qytetarëve të Kosovës. Po e njëjta vlenë edhe për politikanët.

KMDLNj uron deputeten Doarsa Kica-Xhelili për një qëndrim jashtëzakonisht korrekt ndaj sulmeve të pambështetura që po i bëhen duke i uruar sukses në vazhdimin e punës si deputete e Kuvendit të Kosovës, për të mirën e subjektit në të cilin ka kaluar dhe për interes të gjithë qytetarëve të Kosovës, pa bërë fare dallime.

Ndërkaq, për të tejkaluar këto situata të pakëndshme, deputetët e Kuvendit të Kosovës mund të nisin ndryshimin e bazës ligjore që lejon këso kalimesh, me bartje të mandatit duke e kushtëzuar apo sanksionuar me ligj se një deputet që e ndërron subjektin politik nuk mund ta merr me vete mandatin e deputetit të fituar në një subjekt tjetër politik. Deri atëherë duhet të tregohen të përmbajtur në deklaratime publike dhe duhet të mos zbatojnë standarde të dyfishte duke e luajtur lojën e tradhtarit dhe të patriotit!

## Vuçiq: Njohja e Kosovës nga Izraeli na lëndoi

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka folur për njohjen e Kosovës nga Izraeli. Ai ka thënë se Serbia u lëndua nga kjo njohje, teksa tha se izraelitët do t'i konsiderojë gjithmonë si miq të serbëve. "Po, njohja e pavarësisë së

Kosovës nga Izraeli na ka lënduar shumë, por ne bëmë të pamundurën për ta kapërcyer atë situatë. Shpresoj se do të jemi në gjendje t'i rindërtojmë marrëdhëniet tona me mirëbesim dhe se do të jemi në gjendje të krijojmë besim të vërtetë midis dy

kombeve tona", është shprehur Vuçiq për "The Jerusalem Post".

Më tutje, ai ka theksuar se ka një kampanjë ndërkombëtare kundër tij dhe Serbisë, teksa ka shtuar se lajmet për një sulm të mundshëm të Serbisë ndaj Kosovës janë të pavërteta.





## Për tetë muaj janë kryer rreth 2 milionë analiza, për mbi 338 mijë pacientë

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Gjatë vizitës në Klinikën e Biokimisë Mjekësore, ushtruesja e detyrës e drejtorit të përgjithshëm të ShSKUK-së, Pranvera Zejnullahu-Raçi, është njoftuar se për tetë muaj në këtë klinikë janë kryer rreth 2 milionë parametra – analiza për mbi 338 mijë pacientë.

Drejtori i kësaj klinike, Shemsi Veseli, bashkë me specialistët e biokimisë, pasi kanë paraqitur kërkesat për zhvillim të mëtejshëm të kësaj klinike, ka njoftuar në lidhje me disa shërbime të reja që do të fillojnë të kryhen në këtë klinikë që kanë të bëjnë me shërbimin e imunologjisë, analiza të hemostazës dhe

disa parametra të tjera për foshnjat e porsalindura dhe shumë të tjera që më parë nuk janë kryer në këtë klinikë.

Në takim u bisedua lidhur me investimet që do të bëhen në aparaturë mjekësore dhe mirëmbajtjen e saj, po ashtu furnizimin e rregullt me reagensë.



## Deputetja Doarsa Kica-Xhelili kalon në LDK

EPOKA  
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) të enjten i është bashkuar deputetja e Kuvendit të Kosovës, Doarsa Kica-Xhelili. “Si politikane aktive e profesioniste e shquar, ardhja e saj në LDK është vlerë. Për këtë jemi të lumtur të gjithë. Me Doarsën kemi biseduar gjatë mbi politikën, aktivizimin dhe vizionin e Lidhjes sonë për vendin. Pikëpamjet e saj për Kosovën, për të tashmen e të ardhmen e brezave të këtij vendi - për drejtësinë në veçanti - janë vlera që provojmë t'i shpërfaqim me këmbëngulësi në çdo veprim tonin politik”, ka thënë kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku.

Ai ka treguar se me deputeten Kica kanë folur për LDK-në, idetë që ka kjo parti përpara dhe nevojën e ndërtimit të kësaj

rruge së bashku me më të mirët e vendit. “Ky është qëllimi ynë, Doarsa është e tillë, prandaj dhe rrugëtimi ynë i natyrshëm. Ajo ka shumë për t'i dhënë Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtarësisë sonë e idealeve tona të përbashkëta në rrugën e gjatë që na pret përpara”, ka thënë ai. Përgjatë kësaj legjislature të Kuvendit të Kosovës, Doarsa Kica-Xhelili ka shërbyer si kryetare e Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, si dhe anëtare e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër-Korrupsionit. “Puna e saj aktive dhe profesionale në komisione dhe në publik, ka shtyrë përpara nisma që kanë marrë mbështetje të gjerë qytetare në vazhdimësi”, ka thënë Abdixhiku.



## Mbahet “RinCamp 2022” me 100 të rinj nga Kosova dhe Shqipëria



PRISHTINË, 8 SHTATOR - Rreth 100 të rinj nga Kosova dhe Shqipëria kanë marrë pjesë në kampin rinor “RinCamp 2022” në Shqipëri, që erdhi si rezultat i marrëveshjes së bashkëpunimit në fushën e rinisë të nënshkruar mes dy ministrave Hajrulla Çeku dhe Bora Muzhaqi. Në këtë kamp që është mbajtur në Jalë, Vlorë, nga 1 deri më 4 shtator, të rinjtë e dy vendeve patën mundësinë të bashkëbisedojnë mbi këshillimin e karrierës, aktivizimin rinor përmes vullnetarizmit, edukimin, të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore, lidhshipi rinor dhe e folura në publik.

Për katër ditë në këtë event, të rinjtë e dy vendeve, krahas trajnimeve, mbajtën edhe aktivitete argëtimi, muzikë dhe lojëra të ndryshme.

Aktivitete të tilla për të rinjtë pritet të ketë sërish, duke rritur kështu mundësitë për shkëmbime rinore e fuqizuar akoma më tepër marrëdhëniet mes të rinjve shqiptarë ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë.

Ky kamp është mbajtur me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Rinisë së Shqipërisë, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Kosovës dhe Ministrisë së Rinisë dhe Fëmijëve të Shqipërisë.

## Deri në fund të vitit pritet të finalizohen 17 objekte parashkollore

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka bërë me dije të enjten se deri në fund të këtij viti pritet të finalizohen 17 objekte parashkollore ku do të arsimohen dhe edukohen rreth 1 800 fëmijë. Kurti ka thënë se duke krijuar

kushte më të mira infrastrukturore për zhvillimin e procesit mësimor, krijohen parakushte për ngritjen e cilësisë në arsim. “Qeveria e Republikës së Kosovës po planifikon investime domethënëse veçanërisht në

infrastrukturë, në fushën e edukimit në fëmijërinë e hershme dhe teknologji të informacionit e të komunikimit. Për tri vitet e ardhshme qeveria ka siguruar 18 milionë euro për investime fillestare në teknologjinë e informacionit

dhe komunikimit në infrastrukturën përkatëse në shkolla. Po ashtu, deri në fund të këtij viti pritet të finalizohen 17 objekte parashkollore ku do të arsimohen dhe edukohen rreth 1 800 fëmijë”, ka thënë Kurti.





## Sindikata e Sektorit Privat kërkon heqjen e kushtëzimit për marrjen e 50 eurove

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Kryetari i Sindikatës së Pavarur të Sektorit Privat, Jusuf Azemi, ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës ta largojë kushtëzimin për marrjen e 50 eurove në kuadër të Pakos për Inflacionin.

Azemi në një konferencë për medie ka theksuar se shumica e punëtorëve në këtë sektor nuk kanë mundësi t'i marrin këto mjete financiare. "Një kërkesë që është e pashmangshme është ajo se Qeveria e Kosovës duhet ta largojë kushtëzimin lidhur me kompanitë private, nëse ato

japin 50 euro, edhe unë do t'i jap 50 euro", ka thënë Azemi. Sipas tij, nëse nuk largohet ky kushtëzim, atëherë kryeministri Albin Kurti le t'i marrë këto mjete dhe t'i alokojë diku tjetër. "Nëse nuk largohet ky kushtëzim, atëherë i themi kryeministrit merri këto mjete financiare e alokoi kudo qoftë, sepse nga kaluara dhe e sotmja çdo pronar nuk bëhet pjesë, pasi pjesa më e madhe nuk e ka këtë fuqi dhe shpresoj të mos jetë një mashtrim i radhës", ka thënë ai.

Kryeministri Kurti ka bërë me

dije se duke filluar nga ky muaj për zyrtarët publikë do ta ndajnë shtesën prej 50 eurosh, kurse për punëtorët në ndërmarrjet publike do ta ndajnë shumën e njëhershme prej 100 eurosh. Ai ka njoftuar se për pensionistët do ta ndajnë shumën e njëhershme prej 100 eurosh (në tetor), ndërkaq familjet në asistencë sociale do t'i mbështesin duke dyfishuar shumën e asistencës për një muaj.

Kurti, duke përmendur punëtorët privatë, ka thënë se 80 për qind janë të angazhuar



në këtë sektor, e që është prekur më së shumti nga inflacioni. "Do ta mbështesim secilin biznes që i rritë pagat e punëtorëve. Duke

subvencionuar 50 për qind të rritjes së pagës për punëtorë, maksimumi 100 euro për tre muajt e parë", kishte bërë me dije Kurti.

## Prodhuesit kërkojnë që qeveria ta rishikojë vendimin për ndalesën e eksporteve të produkteve esenciale

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Më 13 shtator bëhen pesë muaj kur Qeveria e Kosovës me anë të një vendimi ka kërkuar që të ndalohen përkohësisht për eksport disa nga produktet themelore agro-ushqimore.

Në mbledhjen e 69 të qeverisë, kryeministri Albin Kurti pati thënë se ky vendim po merret në një situatë kur është vështirësuar zinxhiri i furnizimit, i ndikuar nga invazioni dhe agresioni ushtarak rus në Ukrainë. "Invazioni dhe agresioni ushtarak rus në Ukrainë ka ndikuar në zinxhirin e furnizimit me produkte ushqimore në Evropë, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë me institucionet përkatëse dhe aktorët në treg ka përcjellë rritjet e çmimeve të produkteve në vend dhe evidencën e eksporteve të mallrave. Sot MINT ka sjellë vendimin që ndalon eksportin dhe riekportin disa produkte agro-ushqimore", kishte thënë Kurti.

Ndërsa ministrja e Tregtisë, Rozeta Hajdari, ka theksuar se eksporti apo riekporti i këtyre produkteve mund ta rrezikojë furnizimin e qytetarëve në vend. "Eksporti dhe riekporti i



mallrave, sado i vogël që është, mund ta rrezikojë furnizimin e popullatës sonë në të ardhmen. Në bashkëpunim me Doganën e Kosovës dhe duke i përcjellë eksportet në baza ditore, për ta lehtësuar gjendjen, propozojmë që të bëhet ndalimi i përkohshëm i disa produkteve themelore.

Vendimi mbështetet në Ligjin për Tregtinë e Jashtme dhe atë të Brendshme. Ndalohet eksporti apo riekporti i drithërave, miellit, vajit ushqimor, sheqerit dhe kripërave", ka deklaruar Hajdari.

Përfaqësuesit e biznesit në Kosovë këtë vendim e kanë

quajtur të stërzgjatur, duke kërkuar nga qeveria Kurti të rishikohet kjo masë.

Kryetari i Bordit të Klubit të Prodhuesve të Kosovës, Berat Mustafa, në një intervistë për "Telegrafin"-n ka theksuar se vazhdimi i kësaj mase po i rrezikon bizneset në humbjen e tregut. "Ne kemi qenë dakord

me qeverinë në fillim të prillit, ku ishte një panik në popull, në regjion e në Evropë që të merren disa masa për një kohë të caktuar që të mbrohen konsumatorët e që largohet paniku për produktet esenciale. Nuk jemi të pajtimit me ministrin e Tregtisë, Rozeta Hajdari, që këto masa të zgjasin pesë muaj, pra janë masa të stërzgjatura, ku prodhuesit tonë që atë treg që e kanë pasur me rastin e eksportit kanë filluar ta humbin", ka thënë Mustafa.

Sipas tij, Kosova ka mbetur i vetmi vend në rajon që vazhdon t'i ketë këto masa. "Nga informatat që i kemi, disa prodhues që t'i plotësojnë kontratat, po punojnë me rajonin për përpunimin e këtyre produkteve, e kurse prodhuesit vendorë duhet të rrinë e të presin. Jemi i vetmi shtet në rajon e Evropë që kemi mbetur për këto ndalesa të produkteve. Derisa Ukraina e Rusia po luftojnë, asnjëherë nuk i kanë ndaluar eksportet e produkteve esenciale. Një vend që jemi stabil e që kemi një ekonomi stabile, e një zhvillim të konsiderueshëm, pse duhet t'i kemi këto masa", ka shtuar Mustafa.

## Gërxhaliu: Zhvillimi ekonomik edhe më tutje nën hijen e agjendës politike

PRISHTINË, 8 SHTATOR - "Është e vështirë të mendohet zhvillimi ekonomik në Kosovë derisa në agjendën institucionale dominojnë problemet politike. Besoj se Kosova është peng i zhvillimit dhe peng i mungesës së investitorëve të huaj për faktin e problemeve politike dhe mungesës së një marrëveshjeje në mes të Kosovës dhe Serbisë", ka thënë Safet Gërxhaliu, ish-kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës në një intervistë për Buletin Ekonomik.

Sipas Gërxhaliut, në këtë kohë kur Kosova ka nevojë për investime kapitale dhe për projekte prej më të

ndryshmeve ekonomike, qoftë në nivel lokal apo atë qendror, është e pakuptimtë kjo ngurose e institucioneve për të investuar në këto projekte nga të cilat do të përfitonin bizneset dhe përmes afarizmit të krijuar do të krijonin vende të reja të punës për të cilat Kosova ka aq shumë nevojë.

Ai ka theksuar se është e pakuptimtë dhe e paargumentuar që për shtatë muaj të këtij viti nuk është shpenzuar as 10 për qind e buxhetit për investime kapitale, nga e cila mungesë këto mjete po përjetojnë amortizim moral sepse janë të

goditura nga hiperinflacioni, ku 100 euro të sotshme nuk e kanë vlerën e 80 eurove nesër. Gërxhaliu ka qenë recidiv për nevojën e ndërtimit të një termocentrali të ri 600 megavatësh në Kosovë, duke shpjeguar se pse Kosovës i duhet domosd një shkritore për ta valorizuar vlerën e metaleve të shumta të Kosovës dhe pse Kosova duhet të rindërtojë një fabrikë të re të akumulatorëve. Sipas

Gërxhaliut, një ndër fushat më të rëndësishme në botën moderne është digjitalizimi dhe në këtë drejtim Kosova duhet të jetë e orientuar që në pesë vjetët e ardhshme,



digjitalizimin dhe edukimin t'i ketë prioritetet e prioritetëve, jo vetëm për nevojat e

Kosovës, por edhe për eksport të shërbimeve dhe projekteve të sofistikuar.



# Kush janë 5 vitet më të këqija në historinë e njerëzimit



Historia e racës njerëzore, është një sagë e gjerë rrëfimesh magjepsëse. Ndër vite ka pasur shumë triumfe, por më shumë në sy prirën të bien momentet e këqija. Në fakt, ne jemi shumë më të interesuar për luftërat dhe revolucionet sesa për paqen dhe vazhdimësinë. Ndonëse do të ketë gjithmonë debate se cili vit ishte më i keqi absolut, është e pamundur të mohohet se këto 5 vite ishin shumë më të tmerrshëm.

## 1. Viti 536

Dimri i vitit 536 ishte një ngjarje rrëqethëse dhe e pazakontë. Historianët dhe shkencëtarët nuk e dinë ende në detaje se çfarë ndodhi. Por ajo pak që dimë është e tmerrshme. Për shkak të një shpërthimi vullkanik që ndodhi në Islandë, në atmosferën e Tokës u formua një mjegulle madhe. Ajo e dobësoi rrezatimin e diellit, shkaktoi temperatura shumë të ulëta, dhe ditë më të errëta në Hemisferën Veriore. Përveç problemeve në bujqësi dhe urisë, në të gjithë Evropën dhe Azinë përhapën sëmundjet. Në fakt, shumë burime kanë folur për ndikimin e këtij fenomeni, duke përfshirë historianin grek Prokopi: "...Dielli ndriçoi pa shkëlqim, tamam si Hëna, gjatë gjithë këtij viti ... Njerëzit nuk ishin të përjashtuar as nga lufta, murtaja dhe as ndonjë gjë tjetër që të çonte në vdekje". Këto ngjarje tragjike nuk u kufizuan

vetëm në vitin 536. Efektet e dimrit vullkanik u ndjenë për vite me radhë, duke shkaktuar miliona e miliona të vdekur.

## 2. Viti 1315

Të nisura në prillin e vitit 1315, reshjet e dendura të shiut shkatërruan Evropën për 150 ditë me radhë. Ende nuk dihet shkaku i saktë i kësaj ngjarje të pazakontë, por kemi shumë informacione për pasojat. Përmbytjet shkatërruan shumë të korra. Gruri, elbi, tërshëra dhe thekra ishin të pakta, duke shkaktuar ngordhjen e shumë kafshëve bujqësore. Sëmundjet dhe keqshqyerja u përhapën m e shpejtësi, dhe shumë njerëz iu drejtuan masave të dëshpëruara për të mbijetuar, siç ishin aktet e kanibalizmit. Kur uria u bë e padurueshme, familjarët u kthyen kundër njëri-tjetrit. Nuk ishte e pazakontë që njerëzit të hanin kufoma dhe të bastisnin varrezat për të gjetur diçka për të ngrënë. Historianët besojnë në këtë sjellje të pështirë mund të ketë kontribuar ergotizmi (një formë çmendurie që lind kur viktima ha kokra thekre të mykura). Shkalla e kriminalitetit u rrit. Hajdutët hynin në tokat bujqësore, vidhnin të mbjellat dhe ia shisnin ato ofertuesit më të lartë. Kjo ngjarje – e cila tani njihet si Uria e Madhe – shkoi përtej vitit 1315, duke sjellë për disa vite rendimente të ulëta të korrave.

Megjithëse historianët nuk e dinë me siguri, disa kanë vlerësuar se uria e madhe çoi në vdekjen e 1 milion njerëzve.

## 3. Viti 1348

Murtaja bubonike mbërriti në Evropë në tetorin e vitit 1347. Minjtë që bartnin baktere e transportuan Murtajën duke u strehuar nëpër anijet tregtare. Pleshtat që ushqeheshin me këta minj e transmetuan më pas sëmundjen duke kafshuar njerëzit. Viktimat e murtajës përjetonin shumë simptoma, duke filluar nga gjëndrat e mbushura me qelb, deri tek dhimbje e kokës dhe të vjellat. Po ashtu ata shfaqën helmim të gjakut dhe gangrenë. Pjesët e lëkurës u bëheshin shpesh të zeza, kjo është arsyeja pse Murtaja bubonike njihet edhe si Vdekja e Zezë. Në fillim të janarit 1348, qyteti italian i Firences u bë një vatrë e nxehtë e epidemisë. Murtaja zhduk gjysmën e popullsisë së qytetit, dhe u zhvendos në shumë qytete të tjera italiane. Nga Italia, Murtaja kapërceu Alpet dhe depërtoi në Zvicër, Austri, Hungari, Gjermani dhe Francë përpara se të vazhdonte rrugën për në Flandër (Belgjika e sotme), Holandë dhe përtej Kanalit Anglez. Murtaja vazhdoi të bënte kërdinë në të gjithë Evropën për disa vite, duke zhdukur miliona njerëz. Askush nuk e di numrin përfundimtar të vdekjeve, por disa

historianë besojnë se murtaja vrau 1/3 e popullsisë evropiane.

## 4. Viti 1918

Lufta e Parë Botërore pati një ndikim shkatërrues. Kostoja e luftës i rrënoi ekonominë, dhe humbja e jetëve ishte e tmerrshme. Çdo fazë e konfliktit ishte e zymtë, dhe viti i fundit nuk bënte ndonjë përjashtim. Gjatë Ofensivës së 100 Ditëve, gjermanët ishin në një situatë të dëshpëruar. Prodhimi i tyre industrial kishte rënë, ndërsa bllokada britanike i kishte privuar ata nga lëndët e para. Me ndihmën e Forcave të Ekspeditës Amerikane, Fuqitë Aleate goditën linjat gjermane, duke i sprapsur ato në të gjithë Evropën, dhe duke varur miliona ushtarë. Lufta mori fund me nënshkrimin e marrëveshjes së armëpushimit më 11 nëntor. Por nuk ishte vetëm lufta, ajo që e bëri 1918-ën një vit të zymtë. Botës iu desh të përballlej edhe me një katastrofë tjetër: Gripin spanjoll. Në dallim nga shumica e formave të gripit – të cilat janë të lehta – gripin spanjoll ishte potencialisht fatal për të gjitha moshat. Dhimbjet e kokës, të fytyrës dhe ethet ishin simptoma tipike, shpesh shkaku i vdekjes por ishte pneumonia. Gripin spanjoll vazhdoi ta sfiliste botën për disa vjet. Sërish numri i të vdekurve mbetet i paqartë. Por vlerësimet luhaten midis 25-100 milion njerëzve.

## 5. Viti 1942

Lufta e Dytë Botërore ishte edhe më shkatërruese se sa Lufta e Parë Botërore. Duke filluar me pushtimin nazist ndaj Polonisë në shtator 1939, 6 vitet që pasuan ishin disa nga më të errëtat në historinë e njerëzimit. Beteja e Stalingradit, ishte padyshim ngjarja më e tmerrshme Luftën e Dytë Botërore. Ajo nisi në gushtin e vitit 1942 dhe përfundoi në shkurtin e vitit 1943. Hitleri ishte i vendosur të pushtonte me çdo kusht qytetin, si për arsye territoriale ashtu edhe për propagandë, pasi ai ishte emërtuar Stalingrad sipas liderit sovjetik Josif Stalin. Egërsia e luftimeve ishte e jashtëzakonshme. Pjesa më e madhe e betejës varej nga luftimet godinë me godinë, duke përfshirë granatat, bajoneta dhe flakëdhësit. Po ashtu pati shumë bombardime, dhe në fund të betejës, u numëruan mbi 2 milionë viktima. 1942 ishte gjithashtu një nga vitet më të këqija të Holokaustit. Ushtria gjermane dhe Schutzstaffel (SS) ishin në thell njësi të lëvizshme vrasëse, që vrisnin çdo hebre që mund të gjenin në Bashkimin Sovjetik. Për më tepër, gjatë kësaj kohe nazistët vranë gjithashtu miliona hebrinj polakë në dhomat e gazit. E gjithë Lufta e Dytë Botërore ishte e tmerrshme, por viti 1942 ishte ndoshta viti më i tmerrshëm i konfliktit.

*History of Yesterday – Bota.al*



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJOËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Galatasaray zyrtarizon Rashicën dhe tre të tjerë

ISTANBUL, 8 SHTATOR - Reprezentuesi i Kosovës në futboll, Milot Rashica, do të jetë lojtari më i ri i Galatasarayt. Futbollisti "dardan" ka kaluar në formë

huazimi në kampionatin turk nga skuadra e Norwich Cityt. "Milot Rashica, me të cilin filluam negociatat për transferim, ka mbërritur herët në mëngjes në Stamboll", ka

shkruar klubi turk. Ndërsa ylli i Kosovës është shprehur i lumtur që është pjesë e skuadrës turke. "Jam shumë i lumtur që kam ardhur në Stamboll. Kam qenë edhe më

parë. Është shumë mirë që jam te Galatasaray", ka deklaruar Rashica. Tri transferimet e tjera nga kjo skuadër janë Mauro Icardi, Juan Mata dhe Yusuf Demir.



## Ejupi: Rahoveci ka synime të mëdha në kampionatin e ri

Prishtinë, 8 shtator - Skuadrat e elitës po vazhdojnë përgatitjet para edicionit të ri. Garat në Prince Caffè Superligë pritet të jenë shumë interesant për shkak se të gjitha klubet janë përforcuar dhe interesimi është i madh. Kapitani i Rahovecit, Visar Ejupi, ka folur për rrjedhën e përgatitjeve. "Përgatitjet i kemi filluar më 15 gusht, ndërsa këto dy javët e fundit jemi me intensitet të lartë dhe çdo gjë po shkon sipas planit të trajnerit", është shprehur Ejupi për faqen zyrtare të FBK-së, duke shtuar: "Jemi shumë të kënaqur me stërvitje, por edhe të gatshëm ta fillojmë kampionatin". Ai ka folur

për synimet e këtij edicioni me "Vreshtarët". "Synimet tona për këtë vit janë ta bëjmë një kampionat më të mirë sesa ai që e lamë pas, të tregojmë lojë të mirë dhe kualitative me lojtarët e ri, që kanë ardhur në ekip, po ashtu edhe me trajnerin Muhammed Thaqi, ku çdo ditë më shumë na motivon me punën që e bën", ka theksuar Ejupi. Ndeshja e parë për Rahovecin do të jetë ndaj kampionit aktual Golden Eagle Yllit, një sfidë aspak e lehtë për "Vreshtarët", që këtë edicion synojnë paraqitje më të mira për shkak se në edicionin e kaluar përfunduan në vendin e shtatë, duke luajtur në "play-out".



## FFK-ja arrin marrëveshje për sigurimin shëndetësor të futbollistëve



Prishtinë, 8 shtator - Federata e Futbollit e Kosovës vazhdon t'i shërbejë dhe të kujdeset për futbollistët dhe futbollistët. Karshi projekteve të tjera të cilat janë në proces të realizimit, FFK-ja ka arritur ta finalizojë projektin e sigurimit shëndetësor të futbollistëve, që ishte një nga pikat e veçanta në programin "Bashkë për futbollin" të presidentit Ademi për katërvjeçarin e ardhshëm. Për realizimin e këtij projekti të veçantë është arritur marrëveshja me kompaninë "Sigal Uniqa Group Austria", njëherësh partnere disavjeçare e FFK-së. Nga ky projekt do të

përfitojnë: Superligat e të dy konkurrencave, Ligat e Para po ashtu të të dy konkurrencave si dhe Liga e Dytë në konkurrencën e meshkujve. Polica e sigurimit me të cilën do të pajisen të gjithë futbollistët e kategorive të cekura më lart do të jetë e kënaqshme, pasi që do t'i mbulojë lëndimet e zakonshme të futbollistëve dhe njëherësh deri tek ato më të kushtueshmet. FFK-ja uron që futbollistët të kenë shëndetin dhe të punojnë edhe më shumë për ta avancuar futbollin kosovar tutje dhe për të arritur sa më shumë suksese edhe në arenën ndërkombëtare.

## Kuqezinjtë të lumtur që janë rikthyer në elitë

Gjakovë, 8 shtator - Vëllaznimi i Gjakovës është rikthyer në elitë. Pas një viti në Ligën e Parë, kuqezinjtë u rikthyen, por me ambicie më të mëdha. Klubi kuqezi është përforcuar me basketbollistë vendorë dhe të huaj, që të jenë sa më konkurrues në elitë. "Jemi shumë të lumtur që jemi pjesë e Superligës. Tifozët janë shumë të lumtur dhe mezi po e presim

edicionin e ri. Mobilizimi është i madh. Përgatitjet po shkojnë shumë mirë. Gjithashtu, kemi zhvilluar edhe disa ndeshje miqësore", ka thënë Atik Koshi për faqen zyrtare të FBK-së. Skuadrat e elitës kanë bërë shumë përforcime, ku pothuajse të gjitha ndeshjet do të jenë shumë interesante. "Besoj se do të jetë një kampionat shumë interesant

dhe me shumë ndeshje sfiduese. Asnjë përballje nuk do të jetë e lehtë, andaj ne do të japim më të mirën tonë në çdo sfidë në garat e Superligës", ka shtuar Koshi. Vëllaznimi në ndeshjen e parë është mysafir i Bashkimit. "Do të angazhohemi maksimalisht për synimet që i kemi. Do të jetë një 'arrë e fortë' për çdo kundërshtar", nënvizoi basketbollisti i Gjakovës.





## Xavi: Lewandowski është i pangopur, Dembele si Neymari

BARCELONË, 8 SHTATOR - Trajneri i Barcelonës, Xavi Hernandez, ka shijuar debutimin e suksesshëm të skuadrës së tij në Ligën e Kampionëve. 5-1 kundër Viktoria Plzenit në ndeshjen e parë të grupit, ku bëjnë pjesë edhe Bayern Muncheni dhe Interi. Tekniku i katalanasve ka

folur pas ndeshjes duke u thurur elozhe cilësive të lojtarëve. Siç ka bërë me dije "Marca", fjalë të rëndësishme për Lewandowskin, autor i tre golave, por edhe për Ousmane Dembele, i krahasuar me Neymarin. "Tre golat e Lewandowskit? Roberti është

kështu, i pangopur. Jam i lumtur për mënyrën si stërvitet sesi i ndihmon shokët e skuadrës. Është i përlurur, drejton të tjerët dhe bën një punë shumë të mirë në presing. Nuk bëhet fjalë vetëm për të shënuar tre gola", ka thënë Xavi, i cili ka lavdëruar edhe

Dembelen: "Është i lumtur, argëtohet. Është një lojtar që bën diferencën, jep asistime dhe shënon. Është një shigjetë në krahun e djathtë. Nuk dua të bëj shumë komplimente, por aftësia që ka në përballjet një kundër një është në nivelin e Neymarit më të mirë".



## Henry: Mbappe është më i mirë se Haalandi

Paris, 8 shtator - Mesjava në botën e futbollit riktheu Ligën e Kampionëve dhe dy nga yjet që shkëlqyen më së shumti ishin Erling Haaland dhe Kylian Mbappe. Norvegjezi i Manchester City realizoi dygolësh ndaj Sevillas në triumfin e anglezëve me rezultatin 0-4, ndërsa dy herë ndëshkoi edhe sulmuesi i PSG-së, Juventusin në fitoren e francezëve 2-1. Tashmë, me Messin dhe Ronaldon që janë në "perëndim" të karrierës së tyre, ka nisur një debat i ri që lidhet pikërisht me Mbappen dhe Haalandin. Cili është më i mirë? Përgjigjja e kësaj pyetje, në fakt, nuk e vendos aspak në vështirësi Thierry Henry. Legjenda e Francës zgjedh patriotin e tij, ndërsa argumenton se Mbappe, përveç pjesës së finalizimit të aksioneve, është i aftë edhe t'i ndërtojë vetë ato si dhe të asistojë për shokët e skuadrës. "Kylian



Mbappe është një lojtar më i mirë se Erling Haaland. Mbappe është nga ata futbollistë që krijojnë në fushë, asistojnë përveç pjesës së finalizimit që të gjithë e kanë vënë re. Nga ana tjetër, Haaland është

vetëm një finalizues i aksioneve dhe nuk përfshihet shumë në lojën e skuadrës. Mbappe mund të luaj në secilin pozicion të sulmit, ndërsa Haaland vetëm në qendër", ka thënë Henry.

## Përcaktohen gjysmëfinalet për meshkuj dhe femra në US Open


NJU-JORK, 8 SHTATOR - Janë përcaktuar gjysmëfinalistët e grand slamit të US Openit për meshkuj dhe femra në tenis. Te femrat në gjysmëfinalen e parë do të përballen tenistja polake Iga Swiatek, numri 1 në botë dhe ajo bjelloruse Aryna Sabalenka, numri 6 në botë. Në sfidën e dytë do të duelojnë ajo franceze Carolina Garcia (numri 17 në botë) e ajo tuniziane Ons Jabeur (numri 5 në botë). Edhe te meshkujt ka mjaft sfida interesante edhe pse janë eliminuar mjaft nga më të mirët. Në gjysmëfinale do të duelojnë rusi Karen Khachanov dhe norvegjezi Casper Ruud (numri 5 në botë), ndërsa në gjysmëfinalen e dytë do të përballen spanjollli Carlos Alcaraz dhe amerikanë Francis Tiafoe.

### GJYSMËFINALE - FEMRA

I. Swiatek - A. Sabalenka  
C. Garcia - O. Jabeur

### GJYSMËFINALE - MESHKUJ

K. Khachanov - C. Ruud  
C. Alcaraz - F. Tiafoe



## Inzaghi: Duhet performancë e përkryer ndaj një skuadre si Bayerni

Interi pësoi humbje nga Bayern Muncheni me rezultatin 0-2. Trajneri Simone Inzaghi tha se "20 minutat e para ishin dinamike, më pas ishim

përballë një ekipi shumë intensiv, të jashtëzakonshëm, një nga më të mirët në Evropë aktualisht. Duhet të bënim më mirë për ta mbuluar golin e

parë, me topin nga Kimmich që kaloi përmbi. Bëmë më mirë pas atij rasti, krijuam shanse, por bëmë edhe gabime teknike me topin

final", ka thënë Inzaghi. "Dzeko dhe Correa kishin mundësi ta kthenin lojën, por duhet performancë perfekte ndaj një skuadre sikur ajo dhe

ne nuk e patëm atë. Ndeshja ishte e hapur. Nuk duhet të pranohet golin e dytë në minutën e 67", ka shtuar Inzaghi.

### SHKURT

#### Spalletti lavdëron Rrahmanin

Napoli ka mposhtur Liverpoolin me rezultatin 4-1, duke bërë një prej befasive më të mëdha në këtë fillimedicioni në futbollin evropian. Në këtë ndeshje ka shkëlqyer mbrojtësi i Kosovës, Amir Rrahmani. Kapiteni "dardan" ka marrë lëvdata edhe nga trajneri Luciano Spalletti. "Rrahmani bëri ndeshje të shkëlqyer, pa hequr asgjë", ka thënë Spalletti. "Të kesh balancën për ta bërë mbulimin lojtar për lojtar është shumë e vështirë. Edhe Kimi ishte monstruoze, po ashtu. Ata vrapuan edhe në mesfushë duke rikuperuar topa", ka shtuar Spalletti.

#### Demaj e Hajdari me ndeshje të mirë, por humbin për një gol

Kapitenia e Përfaqësueses së Kosovës, Leonora Demaj, ka zhvilluar ndeshje të madhe të mërkurën në elitën e Danimarkës. Demaj i kishte plot tetë gola për Ringkobingun që, megjithatë, u mposht nga Horsens me një gol dallim, 30:29. Horsens kishte një gol epërsi edhe pas pjesës së parë, 15:14. Demaj tetë golat i shënoi nga 11 tentime. Ajo e kishte edhe një asistim. Marigona Hajdari, po ashtu, u shfaq mirë. Ajo shënoi dy gola nga tri tentime, ndërsa i kishte edhe tri asistime. Hajdari - Demaj priten të jenë një dyshe shumë e rëndësishme e Kombëtares sonë për ndeshjet ndaj Ishujve Faroe. Leonora Demaj është shpallur lojtarja më e mirë e ndeshjes së kampionatit të Danimarkës.

#### Marco Rose emërohet trajner i Leipzigut

Marco Rose është emëruar trajner i ri i Leipzigut. Skuadra e RB Leipzigut ka shkarkuar nga pozita e trajnerit Domenico Tedesco, kurse të enjten ka njoftuar për pasuesin e tij. Leipzig i ka ofruar Roses një kontratë deri në vitin 2024. 45-vjeçari do të synojë ta kthejë Leipzigun në formën e viteve të kaluara.

#### Kloppi: Nuk kam frikë nga shkarkimi

Liverpooli pësoi humbje të thellë nga Napoli (4-1), por trajneri Jurgen Klopp ka thënë se nuk ka frikë të shkarkohet si bashkëkombasi i tij, Thomas Tuchel. Ky i fundit u shkarkua pas humbjes që Chelsea pësoi nga Dinamo Zagrebi. "Nuk kam shumë frikë, nuk është kështu. Provarët tanë janë shumë të qetë dhe presin që unë ta zgjidh situatën, jo dikush tjetër. Duhet të gjejmë një lloj të ri futbollit, megjithëse të gjithë do të ishin të lumtur nëse do të luanim si më parë. Nuk kam parë më pak kompakt për një kohë të gjatë. Napoli ishte shumë i mirë, por ne e bëmë të lehtë për të. Na mungojnë shumë. Ne luajmë kundër Wolverhamptonit për tre ditë. Nëse e kanë parë ndeshjen, ndoshta nuk mund të ndalojnë së qeshuri tani. Ata do ta shohin këtë si momentin perfekt për të luajtur kundër Liverpoolit dhe unë do të pajtohesh me këtë", ka thënë Klopp.



**KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË**

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 29.08.2022 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, KRM "Uniteti" SH.A vendosi që me datë 09.09.2022 të shpall:

**KONKURS PUBLIK**

Për plotësimin e vendeve të punës:

**Tre (3) Inkasanta/Arkatar** -Njësia në Mitrovicë me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi

**Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:**

- Bëne inkasimin e mjeteve në bazë të faturave me të cilat ngarkohet materijalisht;
- Bënë zbulimin - regjistrimin me kohë të sipërfaqeve të reja dhe të pargjistruara ;
- Përcjell ndryshimet apo ndërrimet e sipërfaqeve dhe ndryshimet tjera të nevojshme në sektorin e amvisërisë respektivisht komercial duke e njoftuar Shërbimin e faturimit;
- Dorzimin ditor të pazarit nga faturat e inkasuara;
- Përgjegjësi materiale dhe penale për faturat e inkasuara si dhe përgjegjësi në punë;
- Realizimi i normativit të inkasimit i përcaktuar sipas planit të punëdhënësit;
- Kryen edhe punë të tjera të kësaj natyre sipas urdhërësës së eprorit të drejtpërdrejtë;

**Kualifikimet e kërkuara:**

- Të ketë diplomën e shkollës mesme;
- Të prezantoj leternjoftimin;
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës).

**Kushtet e veçanta:**

Punëtori gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do ti vazhdohet apo përrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mund të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë.

Konkursi do të jetë i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 09.09.2022 deri më datën 23.09.2022. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.

**KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË**

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 29.08.2022 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, K.R.M. "Uniteti" Sh.A vendosi që më datë 09.09.2022 të shpall:

**KONKURS PUBLIK**

Për plotësimin e vendeve të punës:

**Dy (2) Vozitës të kategorisë "C"** - Njësia në Mitrovicë me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Sipas Urdhërësës së Punës drejton automjetin dhe kujdeset për rregullësin, higjienën dhe pastërtin e tij,
- Është përgjegjës për vozitje të sigurt dhe për kryerjen me kohë, efikasë dhe kualitative të shërbimeve në bartjen e mbeturinave, larjen e rrugëve etj.
- Në rastet kur e kryen terrenin e caktuar angazhohet në pika (zona), tjera sipas urdhërësës së udhëheqësit-kryepunëtorit,
- Para daljes në teren merr Urdhërësën e Punës në të cilën evidencen punët e kryera, vërejtjet mbi pengesat dhe defektet në automjet, dhe të njetën e kthen te dispeçeri,
- Vendos (monton) letren e re të tahografit ndërsa letren paraprake e kthen te dispeçeri, brenda 12 orëve,
- Vozitësi i cili e monton letren e tahografit ka obligim që në të shenon: Emrin e tij, numrin e regjistrimit të automjetit, datën dhe kilometrazhën fillestare dhe përfundimtare,
- Është i obliguar që në automjet të ketë mjetet e nevojshme të punës (lopapat, fshisat etj.), për ekipën e punëtorëve me të cilët punon, largon (bartë) shtazët e ngordhura dhe i evidenton në urdhëresën e punës.
- Në rast nevojë ndrron gomat e automjetit në teren, apo në punëtorinë e mirëmbajtjes në bashkëpunim me gomisterin,
- Është i obliguar që prishjet në automjet me kohë t'i lajmron me shkrim te udhëheqësi i drejtpërdrejt dhe në punëtorinë e mirëmbajtjes
- Çdo sjellje të pandërgjegjshme të punëtorëve me të cilët punon vozitësi është i obliguar që ta paraqet te udhëheqësi i drejtpërdrejtë
- Kryepunëtori e njofton kryepunëtorin për kontejnerët e dëmtuar dhe sipas kërkesës së tij, bënë bartjen e tyre në punëtorinë e mirëmbajtjes për riparim,
- Është i obliguar që në Deponi të mbeturinave tu përmbahet rregullave dhe obligimeve të parapara në lidhje me procesin e punës në Deponi,
- Nëse automjeti me të cilin punon ndodhet në prishje apo jasht planit momental për përdorim, është i obliguar që të drejton automjet tjetër, dhe të kryen punë tjera sipas urdhërësës së udhëheqësit, të drejtpërdrejt nevojës së procesit të punës dhe interesit të ndërmarrjes.

**Kualifikimet**

- Të ketë diplomën e shkollës mesme
- Vozitës i kategorisë "C"
- Të prezantoj leternjoftimin
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës).

**Kushtet e veçanta:**

Punëtori 6 (gjashtë) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do ti vazhdohet apo përrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat, etj. mund të dorëzohen në Zyrën e Arkivës në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë.

Konkursi do të jetë i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 09.09.2022 deri më datën 23.09.2022. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.

**KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË**

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 29.08.2022 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, KRM "Uniteti" SH.A vendosi që me datë 09.09.2022 të shpall:

**KONKURS PUBLIK**

Për plotësimin e vendeve të punës:

**Një (1) Punëtor Fizik** -Njësia në Mitrovicë me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi

**Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:**

- Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave në automjete – kamion kompaktor dhe traktor;
- Zbrazen e konteinerëve dhe pastrimin e lokacionit rreth tyre nga zona e shërbimit gjerë në deponi;
- Kryen pastrimin, larjen dhe spërkatjen e sipërfaqeve publike, rrugëve dhe shesheve;
- Kryen punët e grumbullimit të mbeturinave në konteiner, kryen punët rreth pastrimit të borës, hedhjes së kripës industriale, heqjen e akullit;
- Është i obliguar të ketë sjellje korrekte ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve;
- Është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të konteinerëve gjatë punës, kryen edhe punë tjera të natyrës së ngajshme të cilat i cakton udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë.

**Kualifikimet e kërkuara:**

- Të ketë diplomën e shkollës fillore ose të mesme;
- Të prezantoj leternjoftimin;
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës).

**Kushtet e veçanta:**

Punëtori gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do ti vazhdohet apo përrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mund të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë.

Konkursi do të jetë i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 09.09.2022 deri më datën 23.09.2022. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

▶ **Labinot Pacolli** shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme Ekonomike "Hoxhë Kadri Prishtina" Prishtinë.

▶ **Naim S. Haliti** shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr 330067381.

▶ **Vitalab SH.P.K.** shpall të pavlefshme dokumentet e biznesit me nrb: 810856536 nr. TVSH: 330459562.

▶ **Ilirjana Duraj** shpall të pavlefshme dëftesat e kl. dhjetë dhe njëmbëdhjetë të Gjimmnazit "Eqrem Çabej" Prishtinë.

▶ **Valdet Hasanaj** nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F. "Selman Riza", Gjakovë.

▶ **Musë Gjoni** nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e klasës: X,XI,XII si dhe diplomën e SH.M.Teknike "Nexhmedin Nixha", Gjakovë.

▶ **Faton Berisha** nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F. Haxhi Hoti" Rogovë, nga klasa: -I- deri -VIII-.

▶ **Qëndrim Rruka** nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimmnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.

▶ **Caner Mazrek** shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren

▶ **Luan Grulaj** shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Dy Dëshmorët " Pirane.

▶ **Lendrit Raduni** shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI- IX shfmu " Ibrahim Fehmiu " Prizren.

▶ **Gzim Krasniqi** shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX shfmu " Fadil Hisari " Prizren.

▶ **Ardian Shabani** shpall të pavlefshme diplomën e Fakultetit të Mjekësisë në UP, Prishtinë.

▶ **Fares Zatriq** shpall të pavlefshme dëftesën e kl. Së dhjetë të shkollës së mesme "Mileniumi i Tretë" Prishtinë.

▶ **Shkumbin Nuli** shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Mehmet Akif" Lipjan.

▶ **Lëshoj garsonjer** me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.



## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Kopshti Lumi” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811407015 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Kopshti Lumi” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811407015 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Kopshti Lumi” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811407015 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook 

[www.facebook.com/gjejpuneshpejite](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejite)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

